



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Ministria e Financave – Ministarstvo za Financije – Ministry of Finance  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 5: Statistikat Sociale**

### **Statistikat e Lindjeve Vdekjeve dhe Kurorëzimeve Janar 2021**



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës / Divizioni i Statistikave të Popullsisë ju njofton se do të filloi publikimin e të dhënave preliminare<sup>1</sup> në baza mujore për Lindjet, Vdekjet dhe Kurorëzimet duke përfshirë muajin Janar 2021.

Këto të dhëna publikohen për herë të parë duke u bazuar në të dhëna administrative.

Burimi i të dhënave është Agjencia për Regjistrim Civil e Kosovës, gjegjësisht Zyrat e Gjendjeve Civile.

Sipas dispozitave ligjore mbi udhëheqjen e regjistrave themeltar për, Lindjet, Vdekjet dhe Kurorëzimet rastet regjistrohen në mënyrë obligative në regjistrat e lartë-cekur, në vendin në të cilin ka ndodhur ngjarja, pa marrë parasysh se personat me të cilët lidhet ngjarja, vendbanimin e përhershëm e kanë në atë vend apo në ndonjë vend tjetër.

Të dhënat statistikore do të publikohen sipas parimit të vendbanimit të përhershëm/zakonshëm të të lindurve, personave të vdekur dhe çifteve të kurorëzuara që sipas rregullave ndërkombëtare i përgjigjet konceptonit të popullatës së përhershme (rezidente).

Përmes kësaj forme, do të krijohet mundësia e krahasimit të të dhënave bazike, duke u bazuar në të dhënat administrative që është kërkesë dhe standard ndërkombëtar i rekomanduar, ku vlerësohet se do të krijohen statistika të sakta, të besueshme dhe të shpejta.

ASK-ja do të vazhdoj me grumbullimin e të dhënave përmes pyetësorëve të veçantë statistikor për Lindjet DEM-1, Vdekjet DEM-2 dhe Kurorëzimet DEM-3 edhe gjatë këtij viti kalendarik, sikurse deri më tani. Grumbullimi i të dhënave vazhdon të bëhet për çdo muaj, kontrollohen në mënyrë kuantitative dhe kualitative. Pas pastrimit të pyetësorëve statistikor do të vazhdohet me procedimin (data/entry), si dhe krijimin e bazës së të dhënave që do të shërbejë për të vlerësuar të dhënat administrative për këtë vit.

Raportet kuartale po ashtu do ta kenë bazën e të dhënave administrative. Raportet vjetore mbi Statistikat Vitale priten të publikohen gjatë muajit qershor dhe korrik të vitit 2021.

Avni Kastrati Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale  
Valdete Navakazi, Shefe e Divizionit të Statistikave të Popullsisë

Në përgatitjen e publikimit kontribuan:

Sanije Uka	-	Zyrtare e Lartë e Statistikave të Popullsisë
Arijeta Sojeva	-	Zyrtare e lartë e Statistikave Vitale
Elvira Tahiri	-	Zyrtare e Statistikave të Popullsisë
Vjollca Berisha	-	Zyrtare e Statistikave Vitale

Prishtinë, Mars 2021

Ud.Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,  
Ilir T.Berisha

---

<sup>1</sup>Shfrytëzuesit e të dhënave iu rekomandohet që këto të dhëna të merren si të dhëna preliminare dhe jo si të dhëna përfundimtare.

**Tabela 1: Të lindur sipas vendit ku ka ndodhur lindja dhe vendit të përhershëm të nënës në komunë, janar 2021<sup>2</sup>**

Komunat	Vendi ku ka ndodhur lindja			Vendi i përhershëm i nënës në komunë		
	Gjinia		Total	Gjinia		Total
	Mashkuj	Femra		Mashkuj	Femra	
Deçan	0	0	0	24	21	45
Gjakovë	83	73	156	64	60	124
Glllogovc	1	1	2	46	36	82
Gjilan	38	53	91	47	46	93
Dragash	1	0	1	27	31	58
Istog	1	1	2	23	24	47
Kaçanik	1	4	5	42	32	74
Klinë	1	1	2	43	35	78
Fushë Kosovë	0	0	0	34	23	57
Kamenicë	0	0	0	12	15	27
Mitrovicë	81	68	149	65	42	107
Leposaviq	0	0	0	6	5	11
Lipjan	1	5	6	40	44	84
Novobërdë	0	0	0	8	5	13
Obiliq	0	1	1	25	20	45
Rahovec	5	6	11	52	43	95
Pejë	74	51	125	71	42	113
Podujevë	1	3	4	76	53	129
Prishtinë	426	353	779	135	110	245
Prizren	112	127	239	130	136	266
Skenderaj	3	5	8	51	57	108
Shtime	0	0	0	27	13	40
Shtërpçë	0	0	0	8	4	12
Suharek	4	3	7	51	42	93
Ferizaj	71	56	127	83	76	159
Viti	5	4	9	33	38	71
Vushtrri	8	13	21	48	44	92
Zubin Potok	0	0	0	6	4	10
Zveçan	0	0	0	5	7	12
Malishevë	6	7	13	58	55	113
Junik	0	0	0	4	1	5
Mamush	0	0	0	5	5	10
Hani i Elezit	0	0	0	3	7	10
Graçanicë	16	10	26	9	7	16
Ranillug	0	0	0	1	1	2
Partesh	3	5	8	1	3	4
Kllokot	0	0	0	3	4	7
Mitrovica e Veriut	15	15	30	9	3	12
Jashtë Kosovës	471	373	844	53	44	97
<b>Gjithsej</b>	<b>1.428</b>	<b>1.238</b>	<b>2.666</b>	<b>1.428</b>	<b>1.238</b>	<b>2.666</b>

Burimi: Agjencia për Regjistrim Civil të Kosovës,

<sup>2</sup> Lindjet e ndodhura në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

**Tabela 2 . Të vdekurit sipas vendit ku ka ndodhur vdekja dhe vendit të banimit të përhershëm në komunë, janar 2021<sup>3</sup>**

Komunat	Vendi ku ka ndodhur vdekja			Vendi i banimit te përhershëm në komunë		
	Gjinia		Total	Gjinia		Total
	Mashkuj	Femra		Mashkuj	Femra	
Deçan	10	9	19	25	13	38
Gjakovë	35	42	77	38	42	80
Glllogovc	16	8	24	24	14	38
Gjilan	48	41	89	55	45	100
Dragash	6	6	12	23	24	47
Istog	8	11	19	22	18	40
Kaçanik	4	6	10	9	12	21
Klinë	7	14	21	15	22	37
Fushë Kosovë	7	9	16	21	13	34
Kamenicë	6	6	12	17	15	32
Mitrovicë	45	25	70	53	28	81
Leposaviq	1	0	1	3	3	6
Lipjan	14	12	26	27	23	50
Novobërdë	3	3	6	5	6	11
Obiliq	6	6	12	12	13	25
Rahovec	16	20	36	28	33	61
Pejë	70	53	123	55	48	103
Podujevë	27	15	42	44	27	71
Prishtinë	234	164	398	109	81	190
Prizren	101	69	170	101	63	164
Skenderaj	5	5	10	18	15	33
Shtime	6	5	11	13	10	23
Shtërpcë	8	1	9	11	3	14
Suharek	14	22	36	32	29	61
Ferizaj	40	42	82	63	38	101
Viti	15	10	25	23	17	40
Vushtrri	20	26	46	26	35	61
Zubin Potok	1	0	1	3	1	4
Zveçan	0	2	2	8	7	15
Malishevë	20	9	29	36	14	50
Junik	2	2	4	3	4	7
Mamush	1	1	2	3	3	6
Hani i Elezit	2	1	3	2	3	5
Graçanicë	11	5	16	16	6	22
Ranillug	2	2	4	2	5	7
Partesh	1	0	1	5	1	6
Klllokot	0	2	2	2	1	3
Mitrovica e Veriut	25	18	43	13	10	23
Jashtë Kosovës	130	75	205	2	2	4
<b>Gjithsej</b>	<b>967</b>	<b>747</b>	<b>1.714</b>	<b>967</b>	<b>747</b>	<b>1.714</b>

Burimi: Agjencia për Regjistrim Civil të Kosovës,

<sup>3</sup> Vdekjet e ndodhura në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

**Tabela 3 . Kurorëzimet sipas komunës të kurorëzimit si dhe vendbanimit të përbashkët të bashkëshortëve pas kurorëzimit, janar 2021<sup>4</sup>**

Komunat	Komuna e kurorëzimit	Vendbanimi përbashkët i bashkëshortëve pas kurorëzimit
Deçan	39	32
Gjakovë	53	45
Glllogovc	56	53
Gjilan	69	64
Dragash	27	22
Istog	46	42
Kaçanik	23	17
Klinë	46	40
Fushë Kosovë	42	36
Kamenicë	24	23
Mitrovicë	61	55
Leposaviq	0	0
Lipjan	55	55
Novobërdë	3	3
Obiliq	18	17
Rahovec	81	73
Pejë	69	48
Podujevë	110	97
Prishtinë	122	106
Prizren	160	141
Skenderaj	59	53
Shtime	30	25
Shtërpcë	6	6
Suharek	103	101
Ferizaj	112	97
Viti	38	32
Vushtrri	76	70
Zubin Potok	3	3
Zveqan	2	2
Malishevë	109	98
Junik	7	5
Mamush	7	4
Hani i Elezit	4	4
Graçanicë	4	4
Ranillug	0	0
Partesh	1	1
Klllokot	0	0
Mitrovica e Veriut	6	6
Jashtë Kosovës	257	142
<b>Gjithsej</b>	<b>1.928</b>	<b>1.622</b>

Burimi: Agjencia për Regjistrim Civil të Kosovës,

<sup>4</sup> Kurorëzimet e ndodhura në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

# Agjencia e statistikave të Kosovës

*përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;*** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruarë terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>